

SHËRBIMET E LEJUARA STOMATOLOGJIKE NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT GJATË PANDEMISË COVID-19

I. PROCEDURAT EMERGJENTE STOMATOLOGJIKE

Kujdesi emergjent stomatologjik fokusohet në menaxhimin e menjëhershëm të rasteve që janë potencialisht kërcënuese për shëndetin e pacientit, siç janë:

- Gjakderdhje e pakontrolluar
- Infeksion bakteror i përhapur në indet e buta (intra-oral apo extra-oral)
- Ënjtje që mund të komprometon rrugët e frymëmarrjes
- Traumat e kockave të fytyrës që mund të komprometojnë rrugët e frymëmarrjes

II. PROCEDURAT URGJENTE STOMATOLOGJIKE

Kujdesi urgjent stomatologjik fokusohet në menaxhimin e rasteve që kërkojnë vëmendje të menjëhershme, që nëse nuk trajtohen mund të komprometojnë në mënyrë të konsiderueshme shëndetin dentar të pacientit, siç janë:

- Dhimbje e fortë e dhëmbit nga pezmatimi i pulpës
- Abscesi ose flegmona dentare, abscesi parodontal akut
- Perikoroniti ose dhimbja nga molari i tretë
- Osteiti pas-operativ
- Fraktura e dhëmbëve që rezulton në dhimbje ose duke shkaktuar traumë të indeve të buta
- Traumat dentare me avulzion / luksacion
- Trajtimi stomatologjik që kërkohet para procedurave kritike mjekësore

III. KUJDESI TJETËR URGJENT STOMATOLOGJIK

- Kariesi ekstenziv ose dëmtimet restauruese që shkaktojnë dhimbje
- Terapia restauruese dhe endodontike për të lehtësuar dhimbjet të cilat nuk menaxhohen nëpërmjet barnave
- Heqja e qepjes (sukurës)
- Cementimi përfundimtar i kurorës / urës dhe ricementimi i tyre
- Riparimi i protezave kur pengohet funksioni
- Menaxhimi i rasteve aktive ortodontike- rregullimi i telit apo aparatit ortodontik që shpojnë ose ulçerojnë mukozën orale